



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA VUSHTRRI

DATË/A:	09.06.2020
PËR/ZA/TO:	Kuvendin Komunal
PROPOZUESI :	Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës
HARTUESI:	Lutfi Gerguri, Drejtor i BF
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rishikimi i buxhetit për vitin 2020

Të nderuar anëtarë të kuvendit,

Duke u mbështetur në Ligjin për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr.03/L-048, Neni 25, 20.8 dhe 22, dhe në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Qeveria do të përgatisë dhe propozojë Kuvendit amendamentet për plotësimin-ndryshimin e Buxhetit të Kosovës për vitin 2020.

Duke u bazuar në Instruksionin për Rishikim të buxhetit për vitin 2020, të marruar më datën 05.06.2020 nga Ministria e Financave dhe Transfereve, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka përgatitur rishikimin e buxhetit.

Andaj kërkojmë nga Asambleja Komunale që të aprovojë Rishikimin e buxhetit për vitin 2020, në mënyrë që të dozojmë në afat të dhënë në bazë të Instruksionit për rishikim, afati i fundit është data 10.06.2020

Rishikimi i buxhetit bëhet sipas shkresës të dërguar në Kuvend.

Shtojcë: Tabelat



Për: Kuvendin e Komunës

Propozues: Xhafer Tahiri, Kryetari i Komunës

Hartues: Lutfi Gërguri, Drejtor për Buxhet dhe Financa

Propozim Vendim: Për rishikimin e Buxhetit të Komunës për vitin 2020

Duke u mbështetur në Ligjin për Menaxhim të Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr.03/L-048, Neni 25, 20.8 dhe 22, dhe në Nenin 8 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenin 12, paragrafi 2 pika "d" dhe të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenin 40, paragrafi 2 pika "dh" dhe 41, paragrafi 2 pika "ç" të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen urgjente të mbajtur më _____ 2020 mori këtë:

V E N D I M
PËR RISHIKIMI E BUXHETIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRIS PËR VITIN 2020

1. Me këtë vendim bëhet rishikimi i buxhetit të Komunës për vitin 2020 sipas kategorive dhe fondit si në vijim:

1. Nga Fondi 10,

1.1 Kategoria Paga dhe Mëditje nga programet:

16024 _ ZYRA E KRYETARIT	(15,000.00)
16324 _ ADMINISTRATA	(21,000.00)
16924 _ ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	(15,000.00)
17524 _ BUXHETI	(25,000.00)
18184 _ INFRASTRUKTURA PUBLIKE	(5,000.00)
18468 _ MENAXHIMI I FATKEQËSIVE NATYRORE	(5,000.00)
19620 _ ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE	(5,000.00)
47024 _ BUJQËSIA	(15,000.00)
65120 _ SHËRBIMET KADASTRALE	(15,000.00)
66425 _ PLANIFIKIMI URBANIZMI INSPEKSIONI	(10,000.00)
73033 _ ADMINISTRATA	(5,000.00)
75616 _ SHËRBIMET SOCIALE	(8,000.00)
75617 _ SHËRBIMET REZIDENCIALE	(11,000.00)
85024 _ SHËRBIMET KULTURORE	(35,000.00)
92120 _ ADMINISTRATA	(10,000.00)

2. Shuma e mjeteve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi barten

Në kategorinë Mallra dhe shërbime në programin ;

18184 _ INFRASTRUKTURA PUBLIKE COVID19 (00099) 200,000.00

3 Mjetet financiare nga kategoria kapitale, programi 18184 Infrastruktura publike

Projekti me Kod 49549 Projektet në bujqësi me bashkëfinancim, shuma (100,000.00),

Barten në kategorinë Mallra dhe shërbime në programin ;

18184 _ INFRASTRUKTURA PUBLIKE COVID19 (00099) 100,000.00

4.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5.Ky vendim hyn në fuqi (15) ditë pas protokollimit në zyrën e protokollit të Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Nasuf Aliu

A r s y e t i m

Duke u mbështetur në Instruksionet e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për rishikimin e buxhetit për vitin 2020 të dt.05.06.2020 , si dhe duke u mbështetur në nevojat e Komunës për financimin e masave si pasojë e pandemisë COVID19 kërkohet që të aprovohet rishikimi i buxhetit të Komunës.

Drejtori i DBF-së



Lutfi Gërguri